

PJESA II

Alber Kamy

I Huaji (fragment)

Megjithatë, jashtë orët kalonin dhe vapa kishte rënë ca. Nga disa zhurma që dëgjoja nga rruga, merrja me mend ëmbëlsinë e mbrëmjes. Ne ishim aty, të gjithë, në pritje. Dhe ajo që prisnim të gjithë së bashku, kishte të bënte vetëm me mua. Vështrova përsëri sallën. Çdo gjë ishte si ditën e parë. Ndesha shikimin e gazetarit me xhakëtë gri dhe të gruas automate. Kjo më bëri të kujtohem se gjatë gjithë procesit nuk e kisha kërkuar me sy Marien. Nuk e kisha harruar por kisha qenë shumë i zënë. E pashë midis Çelestës dhe Rajmondit. Ma bëri me shenjë sikur më thoshte: “Më në fund” dhe pashë fytyrën e saj në ankth që buzëqeshte. Por e ndjeja që zemra më shtrëngonte dhe nuk mundesha as t’i përgjigjesha buzëqeshjes së saj.

Trupi gjykues u kthye në sallë. Shumë shpejt u lexuan një seri pyetjesh drejtuar gjyqtarëve. Dëgjova “fajtor për vrasje”... “paramendim”... “rrethana lehtësuese”. Gjyqtarët dolën dhe mua më çuan në dhomën e vogël ku kisha pritur dhe më parë. Avokati im erdhi të më takojë: ai fliste shumë dhe me besim e përzemërsi si asnjëherë tjetër. Ai mendonte se çdo gjë do të shkonte mirë dhe, se unë do t’ia hidhja me disa vjet burg ose punë të detyruar. E pyeta në se kishte mundësi për anulim vendimi po qe se ky nuk do të ishte në favorin tim. Ai më tha se jo. Taktika e tij kishte qenë të mos acaronte jurinë. Ai më shpjegoi se një vendim nuk anulohet, ashtu, për hiç gjë. M’u duk e qartë dhe iu binda arsyeve të tij. Po ta gjykoje me mendje të kthjellët ishte krejtësisht e natyrshme. Në të kundërtën do të kishte shumë fletushka të kota. “Sidoqoftë, më tha avokati im, është dhe lutja për falje. Por jam i bindur se përfundimi do të jetë i favorshëm.”

Ne pritëm një kohë shumë të gjatë, afër tre çerek ore, më duket. Më në fund tringëlli një zile. Avokati im u largua duke thënë: “Kryetari i jurisë do të lexojë përgjigjet. Juve do t’ju fusin brenda vetëm për formulimin e vendimit.” U përplasën dyer. Njerëz vraponin nëpër shkallë dhe nuk e kuptoja në ishin afër apo larg. Pastaj dëgjova një zë të mbytur të lexonte diçka në sallë. Kur zilja ra përsëri dhe u hap dera, heshtja e sallës u ngrit drejt meje, heshtja, dhe me të ndjenja e veçantë që më pushtoi kur vura re se gazetari i ri i kishte hequr sytë nga unë. Nuk vështrova nga Maria. Nuk pata kohë sepse kryetari tha në mënyrë që disi më habiti se do të më prisnin kokën në mes të një sheshi në emër të popullit francez. Atëherë m’u duk se kuptova ndjenjën që lexoja tek të gjitha fytyrat. Mendoj se ishte respekt. Xhandarët ishin shumë të butë me mua. Avokati e vuri dorën mbi dorën time. Nuk mendoja më për asgjë. Por kryetari më pyeti nëse kisha gjë për të shtuar. U mendova. Thashë: “jo”. Atëherë më morën.

Për pyetjet 13-18 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

13. Romani *I huaji* trajton temën e: **1 pikë**

- A) heroizmit dhe madhësisë
- B) absurdit dhe fatit njerëzor
- C) ripërtëritjes së jetës
- D) diskriminimit racor

14. Subjekti në veprën *I huaji* të Kamysë karakterizohet nga: **1 pikë**

- A) prania e episodeve të domosdoshme
- B) përshkrimi i ngjarjeve deri në imtësi
- C) zhvillime të linjave paralele
- D) mungesa e fabulës së mirëfilltë

15. Në këtë fragment Merso i mbetet i huaj, sepse: **1 pikë**

- A) Maria kërkon ta takojë Mersoin pas dënimit.
- B) ndesh shikimin e Maries në momentin e dhënies së dënimit.
- C) avokati e mbron siç duhet Mersoin.
- D) pret dënimin pa mundur të mbrojë vetveten.

16. Fjala *asnjëherë* është: **1 pikë**

- A) e parme
- B) e përbërë
- C) e përngjitur
- D) e prejardhur

17. Ligjërata e zhdrejtë në paragrafin e dytë (kur Merso komunikon me avokatin) tregon: **1 pikë**

- A) që veprimi po rrjedh shpejt
- B) pamundësinë e Mersoit për të folur
- C) dilemën e Mersoit
- D) që veprimi rrjedh ngadalë

18. Fjalitë: “*Ne pritëm një kohë shumë të gjatë, afër tre çerek ore, më duket. Më në fund tringëlliu një zile*” përcjellin në fragment atmosferë: **1 pikë**

- A) ekzaltimi
- B) lumturie
- C) ankthi
- D) qetësie

19. Përse Merso i ndodhet në sallën e gjyqit? **1 pikë**

20. Arsyetoni mosreagimin e Mersoit ndaj vendimit. Ilustrojeni mendimin tuaj me një shembull nga fragmenti. **2 pikë**

21. a) Zbuloni në fragment dy reagimet e Mersoit në lidhje me Marian. **2 pikë**

b) Çfarë dëshmojnë ato në lidhje me gjendjen shpirtërore të vetë Mersoit? **1 pikë**

22. Vëreni në paragrafin e parë fjalitë ku janë përdorur përemrat *Unë (mua më)* dhe *Ne*.

Kush përfshihet te përemri *Ne*?

Në ç' marrëdhënie vendoset Merso me të pranishmit? Shpjegoni këtë në funksion të ngjarjes që ndodh në këtë fragment.

a) _____ **1 pikë**

b) _____ **1 pikë**

c) _____ **1 pikë**

23. Cili është nënteksti i shprehjeve: *Dëgjova “fajtor për vrasje”... “paramendim”... “rrethana lehtësuese”*? Ç'përcjell Kamy te lexuesi nëpërmjet kuptimit që merret prej tyre?

a) _____ **1 pikë**

b) _____ **1 pikë**

24. Ndaluni në paragrafin e fundit dhe tregoni dy shenja që shërbejnë si paralajmërim për vendimin tragjik.

Ç'tipar i stilit të Kamysë del në shprehjet e mëposhtme?

Por kryetari më pyeti nëse kisha gjë për të shtuar. U mendova . Thashë: “jo”. Atëherë më morën.

a) _____ **2 pikë**

b) _____ **1 pikë**
